



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Datë: 20.08.2025 285

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligji nr.08/L-197 për Zyrat Publike, Rregullores nr.27/2024 për procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës, Komuna e Fushë Kosovës shpallë:

KONKURS

Niveli : IEEA

Titulli i vendit të punës : Shtëpiak NTM3

Institucioni: Komuna e Fushë Kosovës

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

Lloji i pozitës: Nëpunës i shërbimit publik

Numri i pozitave: 6

Koeficienti: Gj 51 4.76

Orët e punës në javë: 40 orë

Periudha provuese : 6 muaj

Periudha e kontratës: Në kohë të pacaktuar

-Kriteret e kualifikimit për Shtëpiak -Përgatitje e mesme shkollore

-Të posedoj diplomë të shkollës së mesme.

- Aftësi komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;

- Te mos kenë dosje penale (te vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente);

- Është e preferueshme të ketë së paku 1 vit përvojë pune në punët dhe detyrat e shtëpiakut

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me aktet juridike, Ligjit për Zyrat Publike nr. 08/L-197, Rregullores nr.27/2024 për procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës.

• KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR PRANIMIN E ZYRTARIT TË SHËRBIMIT PUBLIK:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndësishme institucion publik;
- 1.7. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Duhet të respektojë orarin e punës në përpikmëri,
- Kujdeset për mirëmbajtjen e ndërtesës së Institucionit në pjesët e brendshme dhe të jashtme; Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
- Në rast të defekteve të mëdha, mban kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
- Bën kyçjen dhe çkyçjen e nxemjes qendrore dhe të gjeneratorit elektrik, duke mbajtur edhe evidencën e derivateve.
- Mban Evidencën, Kontrollon dhe monitoron rezervuarin e derivateve dhe lendeve djegëse të cilat mund të jenë të vendosura në lokacionet e IP;
- Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdeset për lulet brenda dhe përreth ndërtesës së IP;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës që momenti i imponon..

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose në web. të Komunës),
 - Rezumeja personale (CV),
 - Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
 - Diplomën e shkollimit të mesëm .
 - Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
 - Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
 - Vërtetimin e përvojës së punës në fushën përkatëse të kërkuar me konkurs, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 3.6. Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

Dokumentet duhet të jenë kopje përveç atyre që kërkohen origjinale (të kërkuarat të jenë të noterizuara) dhe ato nuk kthehen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmjuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

KRITERET E VLERËSIMIT:

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, bëhet sipas kritereve të mëposhtme dhe ato të vendosura në formularët përkatës të Rregullores:

1.Në vlerësim, kandidati mund të marrë më së shumti njëqind (100) pikë, prej të cilave deri në tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV) dhe deri në shtatëdhjetë (70) pikë për intervistën.

AFATI I APLIKIMIT:

Data e njoftimit të konkursit **20.08.2025**

Afati për pranimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë(15) ditë kalendarike nga data **21.08.2025** deri më **04.09.2025**.

MËNYRA E APLIKIMIT

Formulari i aplikimit për punësim merret në zyrën pritëse në Objektin e Komunës së Fushë Kosovës, rruga "Tahir Zemaj" nr. 2 12000 çdo ditë pune, si dhe mund të shkarkohen nga ueb faqja SIMBNJ – konkursi.rks-gov.net.

MËNYRA E DORËZIMIT

Aplikacioni i nënshkruar së bashku me dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrën pritëse në objektin e Komunës.

Rezultatet shpallen në ëeb-faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në intervistë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

